URDHËR
Nr.11, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta"", i ndryshuar, dhe të rregullores nr.622/1, datë 15.12.1992 "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", e ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat njëvjecar do të jenë si më poshtë:

Kategoria	klasa	Tipi i mjetit	Primi i pastër në lekë
A		Motoçikleta	2 600
B			
	.1	Autovetura	5 500
	.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	10 500
C			
	.1	Autobusa mbi 16 vende	17 300
D			
	.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	12 000
	.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	14 000
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	3 000
F		Mjete punimi në bujqësi	2 000
G		Zjarrfikëse	6 000

2. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat 10-ditor do të jenë si më poshtë:

Kategoria	Klasa	Tipi i mjetit	Primi i pastër në lekë
A		Motoçikleta	300
B			
	.1	Autovetura	600
	.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	1 000
C			
	.1	Autobusa mbi 16 vende	4 000
D			

	.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	1300
	.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	3 000
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	1 300
F		Mjete punimi në bujqësi	700
G		Zjarrfikëse	1300

3. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat kufitare do të jenë si më poshtë:

Kategoria	Tipi i mjetit	Primi i pastër në euro				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë
A	Autovetura	16	19	22	26	29
B.1	Motoçikleta	8	10	11	13	16
B.2	Motokarro	10	13	16	19	23
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	54	67	81	87	101
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lart	67	81	87	101	121
D	Çiklomotor	8	10	11	13	16
E	Autobusë	91	104	124	137	163
F.1	Rimorkio kamioni	40	47	53	60	73
F.2	Rimorkio autobusi	53	60	67	73	93
F.3	Rimorkio të tjera	20	27	33	40	47

4. Shpenzimet që do t'i shtohen primit të pastër përllogariten nga shoqëria e sigurimit dhe i njoftohen Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

5. Primi minimal i arkëtuar nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta është i barabartë me primin e pastër (i rrezikut) duke i shtuar shpenzimet sipas pikës 4 të këtij urdhri.

6. Tarifat e primit maksimal nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta janë si më poshtë:

Kontratat me afat 1-vjeçar

Kategoria	lasa	Tipi i mjetit	Primi në lekë
A		Motoçikleta	7 000
B			

	B.1	Autovetura	15 000
	B.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	28 600
C			
	C.1	Autobusa mbi 16 vende	46 200
D			
	D.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	31 600
	D.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	37 800
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	9 200
F		Mjete punimi në bujqësi	7 100
G		Zjarrfikëse	16 400

Kontratat me afat 10-ditor

Kategoria	Klasa	Tipi i mjetit	Primi në lekë
A		Motoçikleta	900
B			
	B.1	Autovetura	1700
	B.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	3500
C			
	C.1	Autobusa mbi 16 vende	10 500
D			
	D.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	3 500
	D.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	7 000
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	3 500
F		Mjete punimi në bujqësi	1700
G		Zjarrfikëse	3 500

Kontratat kufitare

Kategoria	Tipi i mjetit	Primi në euro				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë
A	Autovetura	44	52	61	70	78
B.1	Motoçikleta	21	26	30	35	44
B.2	Motokarro	26	35	44	52	61
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	140	174	209	227	262
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lart	174	209	227	262	314
D	Çiklomotor	21	26	30	35	44
E	Autobusë	244	279	331	366	436
F.1	Rimorkio kamioni	105	122	140	157	192
F.2	Rimorkio autobusi	140	157	174	192	244
F.3	Rimorkio të tjera	52	70	87	105	122

7. Provigjoni teknik i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta përjashtuar kartonin jeshil, përllogaritet si shumë e provigjonit teknik të primit të pafituar dhe provigjonit teknik të dëmeve.

8. Ky provigjon teknik llogaritet në mënyrë të përmuajshme për të gjitha dëmet pezull dhe policat e sigurimit në fuqi në ditën e fundit të muajit, deri në datën 15 të muajit pasardhës.

9. Përllogaritja e provigjonit teknik e primit të pafituar bëhet me metodën e numrit ekzakt të ditëve të policës së sigurimit.

10. Provigjoni teknik i dëmeve përllogaritet mbi bazën e dëmeve pezull duke i shtuar vlerën prej 30% të këtij të fundit.

11. Provigjoni teknik i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta përjashtuar kartonin jeshil, ngurtësohet në një llogari të veçantë në një nga bankat e nivelit të dytë dhe prekja e tij nga ana e shoqërive të sigurimit bëhet vetëm me autorizim nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, me qëllim pagesën e dëmeve që lindin nga ky lloj sigurimi, dhe axhustimet e mundëshme në këtë lloj provigjoni teknik.

12. Kontrolli i provigjoneve teknike nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve të bëhet i përmuajshëm deri në datën 20 të muajit pasardhës.

13. Përllogaritja e TVSH–së bëhet konform ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Shoqëritë e sigurimeve çelin llogari të veçantë në bankat e nivelit të dytë për derdhjen e vlerave të TVSH –së.

14. Tarifat e primeve dhe provigjoni teknik të sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, të përcaktuara në këtë urdhër, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit duke filluar nga data 1.4.2005. Moszbatimi i tarifave të primeve të përcaktuara në këtë urdhër i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165- e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

15. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit të marrin masat për zbatimin e këtij urdhri.

16. Urdhri i Ministrit të Financave nr.2262, datë 1.4.2003 "Për miratimin e primit neto të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", dhe të gjitha aktet e tjera të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

GJYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

Vendim lidhur me pranueshmërinë e aplikimit nr.10513/03 nga Stefan Naumov kundër Shqipërisë, depozituar më 3 dhjetor 2002

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 4 janar 2005 si Dhomë e përbërë prej:

Z.Nikolas Bratza, President
Z.M.Pelonpaa
Z.R.Maruste
Z.K.Traja
Z.S.Pavlovschi
Z.L.Garlicki
Z.J.Sikuta, gjyqtarët
dhe znj.F.Elens-PASSOS, zëvendësregjistrar i seksionit,

duke u mbështetur në aplikimin e mësipërm të depozituar më 3 dhjetor 2002,

duke u mbështetur në vëzhgimet e paraqitura nga qeveria përgjegjëse dhe vëzhgimet e paraqitura nga aplikanti,

pasi ka diskutuar çështjen ka vendosur si më poshtë:

PËRSA U PËRKET FAKTEVE

Aplikanti z.Stefan Naumov është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur më 1945 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri).

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes siç janë paraqitur nga aplikanti mund të përmblidhen si më poshtë:

Aplikanti, një shtetas bullgar, ka qenë Ambasadori Bullgar në Republikën e Shqipërisë nga viti 1990 deri në vitin 1997.

Më 1996 Ministria e Punëve të Jashtme të Bullgarisë inicoi procedim ligjor kundër aplikantit si rrjedhojë e të cilave ai u pezullua nga puna me anë të një urdhri të ministrit.

Më 10 shkurt 1997 Gjykata e Lartë e Bullgarisë anuloi urdhrin e ministrit që e pushonte aplikantin nga puna. Në një ditë të papërcaktuar aplikanti u tërhoq nga jeta politike.

Më 1997 aplikanti dhe familja e tij i kërkuan Presidentit të Republikës së Shqipërisë shtetësinë shqiptare. Më 17 prill 1997 Presidenti i Republikës u dha atyre shtetësinë shqiptare.

Më 20 shtator 2001 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i zgjedhur së fundi, në mënyrë *ex officio* ka deklaruar nul dhe të pavlefshëm dekretin e presidentit të datës 17 prill 1997 duke revokuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të aplikantit me arsyen se ishte siguruar me anë të dokumenteve të falsifikuara. Sipas dekretit, aplikanti kishte paraqitur dokumente të falsifikuara për të treguar se kundër tij nuk ishte filluar asnjë procedim penal në Bullgari.

Më 2 tetor 2001, rreth orës 9.00 një grup me punonjës policie, disa prej tyre të armatosur, shoqëruan aplikantin, së bashku me gruan e tij, në rajonin e policisë së Tiranës për njoftimin zyrtar të dekretit.

Pas disa orësh pritje, aplikantit i është dhënë një kopje e dekretit të presidentit të datës 20 shtator 2001, me anë të të cilit i hiqej shtetësia shqiptare.

Për më tepër, zëvendësshefi i Drejtorisë së Policisë Tiranë urdhëroi verbalisht aplikantin që të largohej nga territori i Shqipërisë më 5 tetor 2001 (d.m.th. brenda tri ditësh) në zbatim të një urdhri dëbimi datë 29 shtator 2001 ose përndryshe do të dëbohej me forcë.

Më 2 tetor 2001 Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një njoftim për shtyp sipas të cilit aplikanti ishte urdhëruar të linte territorin e Shqipërisë më 5 tetor 2001, meqenëse shtetësia shqiptare, që ai kishte fituar me anë të dokumenteve të falsifikuara, i ishte hequr.

Më 4 tetor 2001, policia pa asnjë arsye të dukshme e ndaloi aplikantin dhe familjen e tij të lëvizte nga apartamenti i tyre. Situata u zgjidh me anë të ndërhyrjes së një anëtari të Parlamentit. Më 5 tetor 2001 aplikanti mori një letër nga Drejtoria e Policisë që i kujtonte atij largimin nga territori i Shqipërisë deri në mesnatën e asaj dite.

1. Procedurat kundër dekretit të Presidentit që revokonin shtetësinë

Më 2 tetor 2001 aplikanti depozitoi një padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë duke pretenduar se dekreti i Presidentit i datës 20 shtator 2001, duhej të anulohej si antikushtetues. Për më tepër ai ka kërkuar si masë të përkohshme, që ekzekutimi i urdhrit të dëbimit të pezullohej.

Më 4 tetor 2001 gjykata e rrethit refuzon juridiksionin për shqyrtimin e ankesës së aplikantit dhe përcaktoi Gjykatën Kushtetuese si autoritetin kompetent.

Më 31 dhjetor 2001 Gjykata e Lartë (Kolegji Civil) prishi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 4 tetor 2001 dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në gjykatën e rrethit si autoritetin kompetent për shqyrtimin e ankimit të aplikantit.

Më 23 dhjetor 2002, pas një viti mosveprimi, gjykata e rrethit në rigjykimin e çështjes, vendosi të anulojë dekretin e Presidentit të datës 20 shtator 2001 si të pambështetur, duke konfirmuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të aplikantit.

2. Procedurat kundër urdhrit të dëbimit dhe urdhrit të policisë

Më 5 tetor 2001 aplikanti depozitoi një padi në gjykatën e rrethit Tiranë duke pretenduar që urdhri i dëbimit i datës 29 shtator 2001 dhe urdhri i policisë i datës 5 tetor 2001 të anuloheshin dhe të hidheshin poshtë.

Në bazë të fakteve të paraqitura nga aplikanti, gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë ka zgjatur 2 vjet dhe 6 muaj dhe janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore. Seancat gjyqësore janë shtyrë në disa raste si rezultat i mungesës së pajustifikuar të këshilltarëve ligjorë të Drejtorisë së Policisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këta të fundit kanë munguar në 13 seanca gjyqësore pa dhënë asnjë arsye.

Më 25 mars 2002 gjykata e rrethit ka pezulluar shqyrtimin e ankimit të aplikantit deri në momentin që gjykata të vendoste mbi vlefshmërinë e dekretit të Presidentit.

Më 7 shkurt 2003 gjykata përfundon gjykimin. Brenda një viti ajo ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore dhe në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, ka vazhduar procedurat vetëm në prezencën e aplikantit.

Më 20 mars 2003, në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, gjykata e rrethit ka anuluar urdhrin e dëbimit dhe urdhrin e policisë të datës 5 tetor 2001 si të pambështetur në kriteret ligjore.

B. E drejta e brendshme

1. Neni 92 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që Presidenti i Republikës ka fuqinë të japë dhe të heqë shtetësinë shqiptare në përputhje me ligjin.

2. Pjesa përkatëse e ligjit nr.8389 të datës 5 gusht 1998 mbi dhënien dhe heqjen e shtetësisë shqiptare, shprehet si më poshtë.

Neni 9

Dhënia e shtetësisë me anë të natyralizimit

"Një shtetas i huaj që ka paraqitur një aplikim për përfitimin e shtetësisë shqiptare me anë të natyralizimit duhet të sigurojë nëse i plotëson kërkesat e mëposhtme:

Ai të ketë arritur moshën 18 vjeç; ai ka jetuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë për jo më pak se 5 vjet të njëpasnjëshme; ai ka të ardhura të mjaftueshme dhe shtëpi banimi; ai nuk ka qenë asnjëherë i dënuar në vendin e tij ose në Republikën e Shqipërisë, ose në një shtet të tretë për një vepër penale për të cilën ligji parashikon vendimin me burgim për jo më pak se 3 vjet. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm nëse provohet që vendimi i dënimit është dhënë për arsye politike; ai ka së paku njohuri elementare të gjuhës shqipe; dhe pranimi i tij si një shtetas shqiptar nuk prek sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë…"

Neni 13

Revokimi i vendimit për dhënien e shtetësisë

"Vendimi për dhënine e shtetësisë shqiptare mund të revokohet nëse provohet që të huajt ose personat pa shtetësi kanë mbështetur në mënyrë të qëllimshme aplikimin e tyre për fitimin e shtetësisë shqiptare mbi të dhëna jo të sakta dhe dokumente të falsifikuara…"

PRETENDIMET

1. Aplikanti ankohet në bazë të nenit 5/1 të Konventës për heqjen e lirisë.

2. Duke u mbështetur në nenin 6/1 të Konventës, aplikanti ankohet për procedura të gjata, të padrejta dhe mungesë të pavarësisë dhe paanësisë në gjykatat vendase në gjykimet lidhur me shtetësinë dhe dëbimin e tij.

3. Aplikanti i referohet nenit 8 të Konventës në lidhje me urdhrin e tij të dëbimit.

4. Mbështetur në nenin 10 të Konventës, aplikanti ankohet për persekutimin që ai ka vuajtur për shkak të bindjeve të tij politike.

5. Së fundi ai pretendon shkelje të nenit 3 të protokollit nr.4 dhe/ose nenit 1 të protokollit 7 të Konventës.

PËRSA I PËRKET SË DREJTËS

Aplikanti ankohet për ndalimin e tij të paligjshëm në rajonin e policisë, duke iu referuar nenit 5/1 të Konventës, i cili për aq sa ka lidhje shprehet si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

(f)…në rastet e arrestimit ose burgimit të rregullt të një personi për të parandaluar hyrjen e paligjshme të tij në një vend ose të një personi ndaj të cilit po kryhet një procedurë dëbimi ose ekstradimi…"

Ankimi i aplikantit sipas kësaj dispozite lidhet me kohën që ai ka kaluar në rajonin e policisë për një afat të papërcaktuar më 2 tetor 2001, e cila sipas tij përbën "heqje të lirisë" sipas kuptimit të nenit 5/1 të Konventës.

Gjykata thekson se sipas nenit 35/1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë vetëm ankime, për të cilat janë ezauruar mjetet e brendshme të ankimit dhe të cilat janë paraqitur brenda 6 muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Në mungesë të një ankimi të përshtatshëm kundër një akti të

veçantë, i cili pretendohet të ketë qenë shkelje e Konventës, data kur është marrë ky akt do të konsiderohet si "përfundimtar", në kuptim të zbatmit të afatit 6-mujor (shih Valasinas vs.Lithuania, nr.44558/98, 14 mars 2000).

Gjykata, së pari konstaton se aplikanti nuk ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 5 të Konventës.

Për më tepër duke pranuar se aplikanti nuk ka ankim ligjor sipas kuptimit të nenit 35/1, lidhur me pretendimin "heqje lirie", referuar qëndrimit të tij në rajonin e policisë, ngjarjet për të cilat ankohet në këtë rast lidhen me datën 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se aplikimi të depozitohej në datën 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e aplikimin është paraqitur jashtë afatit kohor.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë, në mbështetje të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

2. Aplikanti ka pretenduar se ka pasur një numër shkeljesh të nenit 6/1 të Konventës i cili për këtë rast shprehet si më poshtë:

"Për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat civile dhe detyrimet…çdokujt i njihet e drejta për një proces të rregullt…brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga një trup gjykues i pavarur dhe i paanshëm i krijuar me ligj…"

Në zbatim të procedurave që lidhen me heqjen e shtetësisë dhe dëbimit, aplikanti ankohet që nuk i është dhënë mundësia për një proces të rregullt gjyqësor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për më tepër aplikanti ankohet që kohëzgjatja e procedurave nuk ka qenë në përputhje me kërkesën "kohë të arsyeshme".

Që në fillim gjykata rithekson se neni 6/1 i Konventës nuk aplikohet për procedurat që rregullojnë shtetësinë e personave dhe/ose hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, pasi procedura të tilla nuk përfshijnë "përcaktimin e të drejtave të tij civile apo detyrimet ose ndonjë akuzë penale kundër tij" në kuptimin e nenit 6/1 të Konventës (shih ndërmjet autoriteteve të tjera, S.Switcerland nr.13325/87, 15 dhjetor 1988, Soc.k.Kroacisë nr.47 863/9, 29 qershor 2000).

Në kuadrin e këtyre rrethanave, gjykata vëren se neni 6/1 i Konventës nuk zbatohet për procedurat që kanë të bëjnë me heqjen e shtetësisë. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e aplikimin duhet të rrëzohet si jo në përputhje me parimin *ratione material* e sipas përcaktimeve të Konventës, në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

3. Aplikanti ka parashtruar se autoritetet shqiptare i kanë shkelur të drejtën për të respektuar jetën e tij private dhe të familjes të garantuar nga neni 8 i Konventës, i cili shprehet si më poshtë:

"1. Çdonjëri ka të drejtë që t'i respektohet jeta private dhe familjare….

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e nevojshme në interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose të mirëqenies ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.".

Aplikanti ankohet lidhur me publikimin në opinionin publik dhe shpalljen e bërë me këtë rast me anë të shtypit për dëbimin e tij si rrjedhojë e heqjes së shtetësisë së tij shqiptare nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Aplikanti ankohet se ky demaskim duhet konsideruar si shkelje e së drejtës së tij për t'i respektuar jetën e tij private dhe reputacionin e tij, pavarësisht nga ligjshmëria e aktit që i heq atij shtetësinë shqiptare.

Gjykata vëren se, ashtu si në rastin e ankimit të tij për nenin 5 të Konventës, aplikanti nuk ka çelur një procedim gjyqësor në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 8 të Konventës.

Duke presupozuar që aplikanti nuk ka asnjë ankim ligjor për pretendimin e tij lidhur me demaskimin publik për shkak të heqjes së shtetësisë së tij, gjykata vëren se një demaskim i tillë ka ndodhur më 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se aplikimi të depozitohet më 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e ankimit është paraqitur jashtë afatit.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

4. Aplikanti është ankuar se persekutimi që ai ka vuajtur për arsye të bindjeve të tij politike dhe të kaluarës së tij demokratike, është shkelje e nenit 10 të Konventës që shprehet si më poshtë vijon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë e dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet nga kërkesa për licencimin e sipërmarrjeve të radiodifuzionit, kinemasë dhe televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që mbartin detyrime dhe përgjegjësi, mund të jetë subjekt i disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose penalizimeve siç janë parashikuar nga ligji dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit, parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve për parandalimin e përhapjes së informacionit konfidencial ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.”.

Gjykata vëren se aplikanti nuk ka paraqitur ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë gjykata është e mendimit se aplikanti nuk ka mundur të provojë thëniet e tij dhe të paraqesë një pretendim të argumentuar për shkelje të këtij neni.

Kështu që, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

5. Aplikanti ankohet në mënyrë të alternuar se urdhri i dëbimit ka shkelur nenin 3 të protokollit nr.4 ose nenin 1 të protokollit nr.7 të Konventës.

Neni 3 i protokollit nr.4 të Konventës në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1.Askush nuk mund të dëbohet me anë të një mase individuale ose kolektive, nga territori i shtetit, shtetas i të cilit është.”.

Neni 1 i protokollit nr.7 të Konventës, në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1. Një i huaj, rezident i ligjshëm në territorin e një shteti nuk mund të dëbohet prej aty, përveçse në rast se zbatohet një vendim i cili është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

a) të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij,

b) të kërkojë rishikimin e çështjes së tij,

c) të përfaqësohet për këtë qëllim përpara autoriteteve kompetente ose një apo disa personave të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet para se të ushtrohen të drejtat e tij sipas paragrafit 1 (a), (b) dhe (c) të këtij neni, kur një dëbim i tillë është i nevojshëm në interes të rendit publik ose është i bazuar në arsyet e sigurisë kombëtare.”.

Aplikanti pohon se urdhri i dëbimit ishte shkelje e nenit 3 të protokollit nr.4 ose nenit 1 të protokollit nr.7, pasi nuk ishte përcaktuar se kur merrte fuqi ligjore dekreti i Presidentit i datës 20 shtator 2001 që revokonte shtetësinë shqiptare të tij.

Lidhur me ankimin e aplikantit për nenin 3 të protokollit nr.4, gjykata vëren se për arsye të dekretit të Presidentit, datë 20 shtator 2001, aplikanti nuk kishte shtetësi shqiptare në kohën e lëshimit të urdhrit të dëbimit të tij më 29 shtator 2001.

Edhe pse në disa raste revokimi i shtetësisë i ndjekur me dëbim mund të sjellë probleme potenciale sipas nenit 3 të protokollit nr. 4, nisur nga fakti që urdhri i dëbimit nuk është ekzekutuar, gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka elemente të shkeljes së këtij neni.

Për rrjedhojë kjo pjesë e aplikimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Përsa i përket ankimit të aplikantit sipas nenit 1 të protokollit nr.7, gjykata vëren se aplikanti asnjëherë nuk u dëbua nga Shqipëria dhe nuk janë ndërmarrë masa për zbatimin forcërisht të urdhrave të policisë të datave 29 shtator dhe 5 tetor 2001. Për më tepër aplikanti ishte në gjendje të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij dhe çështja e tij u rishikua nga gjykatat vendase, të cilat më 20 mars 2003 kanë deklaruar urdhrat të pavlefshëm duke ndjekur anulimin e dekretit të Presidentit që i hiqte shtetësinë shqiptare aplikantit.

Prandaj ankimi i aplikantit sipas nenit 1 të protokollit nr.7 është i papranueshëm dhe haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, gjykata në mënyrë unanime,

deklaron aplikimin të papranueshëm.

Zëvendësregjistrar Francoise Elens-Passos	President Nicolas Bratza